



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:062895

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610828

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit K.. T., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.479/23 të datës 18.10.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.04.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 22.04.2024, lidhur në mes të pandehurit K.. T.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar DHF –C.. me seli në Pejë.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.479/23 të datës 18.10.2023.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit K.. T., i lindur me 18.10.1991 në Pejë, me vendbanim në fsh K.. i R. K e P.. rr “O.. T..”, i atësisë Sh.. dhe amësisë E.. e vajzërisë K., i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i identifikuar në baze të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr të telefonit ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 26.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.479/23 të datës 18.10.2023 ndaj të pandehurit K.. T.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 22.04.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit K.. T.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar DHF –C... me seli në P., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 22.04.2024, lidhur në mes të pandehurit K.. T.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar DHF –C.... me seli në P..ë.

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2023:062895, 23.04.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gj y q t a r i**

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi